



Република Северна Македонија
НАРОДЕН ПРАВОВАНИТЕЛ
Republika e Maqedonisë së Veriut
AVOKATI I POPULLIT
Republic of North Macedonia
O M B U D S M A N

Më datë **07.09.2018**, Mekanizmi Parandalues Nacional realizoi vizitë të rregullt të paparalajmëruar në Stacionin Policor për Kontrollë Kufitare dhe Mbikëqyrje Kufitare (SP për KK dhe MK) Bellanovc, i cili është vendosur në objektin e Seksionit Policor (SP) Matejçe, i cili gjendet në fshatin Matejç. Në hyrje të objektit, përveç tabelës nga e cila mund të konstatohet se bëhet fjalë për Seksion Policor Matejç, nuk u vërehej asnjë shenjë adekuate se në kuadër të objektit është vendosur Stacioni Policor për Kontrollë Kufitare dhe Mbikëqyrje Kufitare Bellanovc.

Vizita u realizua konform mandatit të Avokatit të Popullit - Mekanizmi Parandalues Nacional, i përcaktuar në Protokollin Fakultativ ndaj Konventës Kundër Torturës dhe Veprimeve tjera Brutale, Johumane, Përçmuese ose Ndëshkues. Me Protokollin Fakultativ definohet zbatimi i vizitave të rregullta në vendet ku mund të kryhet privimi nga liria i personave, me qëllim të identifikimit të rreziqeve dhe parandalimit të torturës ose llojeve tjera të veprimit brutal, jonjerëzor, përçmues ose ndëshkues.

Ekipi i MPN hasi në bashkëpunim dhe kooperativitet të mirë nga ana personave zyrtarë të punësuar në Stacionin Policor, të cilët mundësuan qasje papengesë deri te të gjitha hapësirat dhe instalimet, si dhe këqyrje në dokumentacionin e kërkuar.

Gjatë këqyrjes së realizuar në zyrat e Stacionit, nuk u vërejtën mjete dhe as sende tjera të dyshimta, me të cilat do të mund të kryhej frikësimi i të paraburgosurve, përkatësisht personave të privuar nga liria dhe personave të ndaluar, por fill para hyrjes së zyrës së zëvendës-epropolit, në dollapin i cili gjendet afër derës kishte një shufër metali, e cila eventualisht do të mund të përdorej për frikësimin e personave me të cilët do të zhvillohej bisedë në zyrë. Përkatësisht, vet fakti se kjo shufër qëndron në vend të

dukshëm, shumë pranë derës së zyrës ku zhvillohen bisedat, do të mund të krijoj frikë tek personat e shoqëruar për bisedë në zyrën konkrete.

Stacioni Policor nuk disponon me kërkesa për njohjen e të drejtës së azilit dhe me listë të emrave të avokatëve, për rastet kur ndonjë person do të kërkoj se dëshiron të thërret avokat.

Ekipi i MPN konstatoi se në SP për KK dhe MK Bellanovc zbatohen trajnime të rregullta dhe të vazhdueshme për Procedurat Standarde Operative, të cilat kanë të bëjnë me kategoritë vulnerabile të huaj, fëmijë të pashoqëruar, si dhe për identifikimin e viktimave të trafikimit me qenie njerëzore.

Stacioni Policor për KK MK Bellanovc nuk është përcaktuar si Stacion Policor në të cilin do të mund të kryhej ndalimi i personave, për shkak se i njëjti nuk ka në dispozicion hapësira të posaçme për ndalim. Në rastet kur ka nevojë për ndalim në këtë Stacion, bisedat zhvillohen në zyrën e zëvendës-eprorit.

Ekipi i MPN konstatoi se, nga mënyra me të cilën ishte theksuar veprimi në rastet kur nëpunësit policorë të këtij Stacioni Policor do të hasnin persona-të huaj në zonën kufitare, mund të konstatohet se nuk bëhet vlerësimi fillestar me qëllim të identifikimit të vulnerabilitetit eventual të personave të hasur e që këta nëpunës policorë do të duhej ta bënë aty për aty, përkatësisht në vendin ku janë gjetur këta persona, por menjëherë njoftohen inspektorët e QR për ÇK Veri ose SPM Kumanovë nga të cilët pranojnë instruksione të mëtutjeshme. Në numrin më të madh të rasteve pranohen udhëzime që personat të transferohen në Qendrën Transitore të Pranimit (QTP) Tabanoc, përveç në rastet kur do të konstatohet se është kryer vepër e caktuar penale dhe personat shoqërohen deri në SP Kumanovë.

Lidhur me udhëzimet për të drejtat, në hyrje të Stacionit Policor, në vend të dukshëm është vendosur poster i në të cilin janë theksuar të drejtat e të thirrurve, të arrestuarve dhe të personave të ndaluar në gjashtë gjuhë, ndërkaq po ashtu në vend të dukshëm në korridor është vendosur Kodeksi i etikës policore.

Higjiena në hapësirat ishte në nivel adekuat, ndërsa në zyrën e zëvendës-eprorit, në të cilën në situata të jashtëzakonshme zhvillohen biseda me personat të cilët arrestohet për një kohë të shkurtër në Stacionin Policor, nuk ishin vendosur udhëzime për të drejtat.

Ekipi i MPN konstatoi se largësia e Stacionit Policor nga linja kufitare manifestohet në planifikimin e aktiviteteve dhe efikasitetin e policisë.

Ekipi i MPN konstatoi se në Regjistrat për evidencë janë vërejtur lëshime në evidentimin e ngjarjeve dhe plotësimin e rubrikave.

Për vizitën, Mekanizmi Parandalues Nacional hartoi Raport të posaçëm në të cilin i konstatoi gjendjet pozitive dhe negative dhe drejtoi rekomandime konkrete deri te Ministria e Punëve të Brendshme, si dhe deri te eprori i Stacionit Policor, me qëllim që të eliminohen mangësitë e theksuara dhe të përmirësohen kushtet dhe veprimi me personat e privuar nga liria, personat e paraburgosur dhe personat e ndaluar.